

Rrregulli për ndeshjet e ndërprera/anuluara

Në rast të ndryshimit të terminit të luajtjes së ndeshjes, rezultati i arritur konsiderohet i vlefshëm në qoftë se ndeshja është luajtur brenda afatit prej 50 orëve nga koha e shënuar në ofertën për vënie të bastit.

Në rast se gara sportive nuk mbahet brenda afatit prej 50 orëve nga paragrafi 1 i këtij neni, për ngjarjen nga kjo garë sportive llogaritet kuota 1.00 (një).

Në rast të ndërprerjes së ngjarjes sportive te basti në ngjarjen në vazhdim (livebet), kurdo gjatë ndeshjes, të gjitha bastet në ngjarjen në vazhdim rezultati i së cilës është realizuar deri në momentin e ndërprerjes mbeten të vlefshme.

Te bastet për ngjarjen në vazhdim (livebet), nëse ngjarja sportive ndërpritet dhe vazhdimi i saj ndodh brenda afatit prej 12 orëve (12 orë nga momenti kur ngjarja sportive ka filluar për herë të parë), të gjitha bastet e paguara gjatë zhvillimit të saj para ndërprerjes të cilat nuk janë realizuar vlejné edhe në terminin e vazhduar.

Nëse vjen deri te ndërprerja e ndeshjes para përfundimit zyrtar dhe ajo nuk zhvillohet brenda afatit prej 50 orëve - çështja nëse basti do të konsiderohet i vlefshëm apo jo varet nga sporti.

Sportet që mund të ndahen në dy pjesë (gjysmëlojë) (Futbolli, Basketbolli, Hendbolli, Vaterpolo, Ragbi dhe të ngjashme):

Në rast të ndërprerjes së ndeshjes në pjesën (gjysmëlojën) e parë, llogaritet kuota 1.00 për të gjitha llojet e basteve.

Nëse ndeshja ndërpritet pas përfundimit të pjesës (gjysmëlojës) së parë dhe para fillimit të pjesës (gjysmëlojës) së dytë, për bastet të cilat janë realizuar deri në atë kohë, rezultati në momentin e ndërprerjes llogaritet për të gjitha llojet e basteve, përkatësisht tiketat në këtë rast mund të jenë fituese (tiketat të cilat padyshim mund të trajtohen si fituese) ose humbëse (tiketat të cilat padyshim mund të trajtohen si humbëse), ndërsa për bastet të cilat nuk janë realizuar shpallet kuota 1.00.

Nëse ndeshja ndërpritet pas fillimit të pjesës (gjysmëlojës) së dytë, rezultati në momentin e ndërprerjes është përfundimtar dhe është i vlefshëm për të gjitha llojet e lojërave.

Sportet të cilat e kanë paraprakisht të njohur kohëzgjatjen e ndeshjes dhe që përbëhen prej tre të tretave (Hokeji dhe të ngjashme): Nëse ndeshja ndërpritet gjatë 2 të tretave të para, bastet shpallen të pavlefshme për të gjitha llojet e lojërave. Nëse ndeshja ndërpritet pas përfundimit të tretës së dytë dhe para fillimit të tretës së tretë, si dhe kurdo gjatë tretës së tretë, rezultati në momentin e ndërprerjes është i vlefshëm për të gjitha llojet e lojërave.

Sportet kolektive që nuk e kanë të njohur paraprakisht kohëzgjatjen dhe fituesi është ai i cili i pari i fiton tre sete (Volejbolli dhe të ngjashme): Nëse kanë përfunduar 3 sete, rezultati i arritur vlen për të gjitha llojet e lojërave, në të kundërtën bastet konsiderohen të pavlefshme dhe llogaritet kuota 1.

Tenisi: Nëse vjen deri te dorëzimi i ndeshjes llogaritet kuota 1 për të gjitha llojet e lojërave pa marrë

parasysh në të cilin set është dorëzuar ndeshja. Nëse vjen deri te dorëzimi para fillimit të ndeshjes vlen kuota 1. Për ndeshjet e tenisit nuk vlen rregulla e kuotës 1, në qoftë se ndeshja nuk kryhet brenda afatit prej 50 orëve.

Bejsbolli: Nëse vjen deri te ndërprerja e ndeshjes për çfarëdo arsye dhe ajo nuk vazhdohet deri në fund të ditës së bastit - llogaritet kuota 1.00 (një) për të gjitha llojet e lojërave.

Nëse ngjarja sportive ndërpritet në rast të bastit për një ngjarje në vazhdim dhe deri te vazhdimi i saj nuk vjen brenda afatit prej 12 orëve (12 orë nga momenti kur ngjarja sportive ka filluar për herë të parë), të gjitha bastet që janë paguar gjatë kohës së zhvillimit të ngjarjes në vazhdim dhe që nuk janë realizuar, konsiderohen të pavlefshme dhe për të njëjtat vlen kuota 1.00.

Pavarësisht paragrafit të mësipërm të këtij neni, në qoftë se një ndeshje tenisi ndërpritet në rastet e basteve për ngjarjet në vazhdim, ndersa ajo ndeshje nuk vazhdon brenda 24 orëve nga koha e ndërprerjes, të gjitha bastet e paguara gjatë kohëzgjatjes së ngjarjes, para ndërprerjes e të cilat nëse nuk janë realizuar, konsiderohen të pavlefshme dhe për ato vlen kuota 1.00